



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2024:176324

Datë: 11.02.2025

Numri i dokumentit: 06832041

**2024:176325**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL**, me gjyqtarin Driton Ahmeti, në çështjen juridike të paditëses F.B, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. Filloreta Hasani nga Ferizaj, kundër të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit, Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike kompensimin e pagës bazë në bazë të kualifikimit, pas shqyrtimit të parashtrësës të datës 04.02.2025, ndërsa më datë 11.02.2025, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

Padia e paditëses F.B, kundër të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit, Komuna e Ferizajt, me objekt kontesti kompensimin e pagës bazë në bazë të kualifikimit **KONSTATOHET E TËRHEQUR**.

**A r s y e t i m**

Paditësja F.B, përmes të autorizuarës së saj me datë 24.06.2024, ka paraqitur padi kundër të paditurës Drejtoria Komunale e Arsimit, Komuna e Ferizajt, me bazë juridike kompensimin e pagës bazë në bazë të kualifikimit.

Gjykata me datë 04.02.2025, nga e autorizuar e paditëses av. Filloreta Hasani, pranë kësaj gjykate ka pranuar parashtrësën për tërheqje të padisë, në çështjen objekt kontesti kompensimin e pagës bazë në bazë të kualifikimit.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**C.nr.2024:176325, me datë 11.02.2025**

**Gjyqtari,  
Driton Ahmeti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.